



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29 Janar 2022

Nr. 28

VENDIM

PËR

**EMËRIMIN E KRYETARËVE DHE ZËVENDËSKRYETARËVE TË
KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET
E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE NË BASHKITË SHKODËR,
DIBËR, DURRËS, VORË, RROGOZHINË DHE LUSHNJË, TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të neneve 19, pikat 1, shkronjat “b” dhe “n”, e 2 dhe 29 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 20.11.2021 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Referuar nenit 9, pika 8, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, miratuar nga Komisioni Rregullator me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve emëron kryetarët dhe zëvendëskryetarët e KZAZ-ve sipas propozimeve të KZAZ-së.

Komisionet e 13 (trembëdhjetë) Zonave të Administrimit Zgjedhor, zhvilluan mbledhjen e parë në selitë përkatëse, në datën dhe orën e përcaktuar në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 25, datë 27.01.2022 “Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor të ZAZ-ve nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 19, nr. 21, nr. 22, nr. 23, nr. 24, nr. 26, nr. 43, nr. 54, nr. 55 për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë të datës 6 Mars 2022”.



Data: 29 Janar 2022
Nr. 28

“Për emërimin e kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, të datës 6 Mars 2022”

Në mbledhjen e parë, 13 (trembëdhjetë) KZAZ-të kanë marrë vendim për propozimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZAZ-së, në përputhje me përcaktimet e pikave 2, 3, 4, 5, dhe 6, të nenit 9 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, miratuar nga Komisioni Rregullator me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020.

Vendimet e KZAZ-ve, për propozimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të KZAZ-së, janë administruar në KQZ.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “b”, e 2 dhe 29, pika 2 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 5, datë 20.11.2021 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”,

V E N D O S I:

1. Të emërojë kryetarët dhe zëvendëskryetarët e 13 (trembëdhjetë) Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, nga publikimi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

